# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6382
E hënë, 9 gusht 2021
çmimi 0.40 €


## Me lot në sy Messi i thotë lamtumirë Barcelonës

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", ADRI NURELLARI FAQE 4-5

# PDK-ja DO TË KETË RIMËKËMBJE TË SHPEJTË



Anëtari i Kryesisë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adri Nurellari, ka thënë se kjo parti do të jetë garanci e ekuilibrit demokratik kundrejt rrezikut të tiranisë së shumicës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se PDK-ja do të jetë ndërgjegjja e demokracisë së Kosovës. Sipas tij, opozitarizmi i PDK-së do të jetë zë i qytetarëve, zë i interesit të shtetit dhe interesit të kombit. Nurellari ka thënë se madhësisë së numrave të qeverisë PDK-ja do t'i përgjigjet me epërsi morale. Duke përmendur arsyet e angazhimit në këtë parti, ai është shprehur i bindur se PDK-ja do të ketë një rimëkëmbje të shpejtë

## Mehaj: Ushtria amerikane, garantuese e sigurisë në Kosovë

FAQE 7



## Mbi 50 mijë qytetarë të Kosovës drejt Shqipërisë për fundjavë

FAQE 6



## AKTUALE




### ÇËSHTJE DITËSH, ZYRTARIZIMI I KANDIDATURAVE TË LV-SË PËR ZGJEDHJET LOKALE F. 5

### RRETH 2 000 RASTE AKTIVE ME COVID NË KOSOVË, BËHET THIRRJE PËR VAKSINIM F. 6

### SEJDI HOXHA JEP DORËHEQJE NGA KRYETARI I DEGËS SË PDK-së NË DRENAS F. 3




## EKONOMI

### BERISHA: KOSOVA DUHET T'I MARRË SHEMBULL SHTETET E TJERA PËR ULJEN E ÇMIMIT TË BILETAVE TË AVIONIT F. 8

### AEROPORTI I GJAKOVËS, ENDE JASHTË FUNKSIONIT F. 8



## SPORT

### PËRFUNDOJNË LOJËRAT OLIMPIKE "TOKIO 2020" F. 14


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

## Greqia në luftë me zjarret



ATHINË, 8 GUSHT - Qindra zjarrfikës grekë luftuan të dielën me zjarret në ishullin Evia. Zjarret kanë djegur zona të gjera me pyje, kanë shkatërruar shtëpitë si dhe kanë detyruar turistët dhe vendasit të largohen.
Ka dy javë që Greqia dhe Turqia po luftojnë me zjarret shkatërruese, pasi rajoni po përballet me valën e tij më të keqe të të nxehtit në disa dekada.
Zyrtarët dhe ekspertët kanë thënë se kjo situatë është pasojë e ndryshimit të klimës.
Deri më tani nga zjarret kanë humbur jetën dy persona në Greqi dhe tetë në Turqinë fqinje, si dhe dhjetëra të tjerë janë shtruar në spital.
Derisa në Turqi reshjet e shiut e qetësuan pak situatën, në Greqi temperaturat po vazhdojnë të jenë të larta. Ishulli Evia, i cili shtrihet në lindje të kryeqytetit, po e pëson më së keqi me mijëra hektarë të kthyera në hi dhe shkatërrime të shtëpive. Mijëra njerëz janë evakuuar.
Zjarrfikësve grekë po u dalin në ndihmë edhe zjarrfikësit nga vendet e tjera, përfshirë Ukrainën dhe Rumaninë.

# Izraeli hap qendra testimi për Covid-19 në gjithë vendin

JERUSALEM, 8 GUSHT - Të dielën Izraeli hapi qendra për testime të shpejta të koronavirusit në të gjithë vendin, njoftoi shërbimi i urgjencës Magen David Adom (MDA).
Qeveria izraelite është duke bërë përpjekje që të shmangë një izolim tjetër, pas rritjes së rasteve të reja me koronavirus. Disa masa shtesë të kufizimit tashmë janë vendosur, por autoritetet thonë se do të bëjnë çdo gjë për të shmangur një mbyllje të plotë.
"Pas një kërkese nga Ministria e Shëndetësisë u hapën 120 stacione të testimit në tërë vendin", thuhej në një deklaratë të MDA-së. Rezultatet në këto



qendra merren për 15 minuta dhe përmes tyre po synohet të testohen personat që nuk janë vaksinuar dhe ata që janë shëruar nga Covid-19.
Gjatë javës së kaluar Izraeli ka regjistruar mesatarisht më shumë se 3 000 raste të reja të koronavirusit në ditë. Kjo është shifra më e lartë që nga muaji prill. "Bllokimi i plotë do të vendoset si masë e fundit dhe ne do të bëjmë gjithçka për ta shmangur atë", tha ministri i Shëndetësisë së Izraelit, Nitzan Horowitz.
Izraeli ishte një nga vendet e para që filloi fushatën e imunizimit kundër Covid-19 në dhjetorin e vitit të kaluar falë një marrëveshjeje me kompaninë farmaceutike "Pfizer" që i mundësoi qasje në miliona doza të vaksinës. Gati 60 për qind e 9.3 milionë qytetarëve të Izraelit kanë marrë dy doza të vaksinës, kryesisht "Pfizer/BioNTech". Por, rreth një milion izraelitë ende refuzojnë të vaksinohen edhe pse e gëzojnë këtë të drejtë.
Numri i rasteve të reja shënoi rritje pas paraqitjes së variantit "Delta" të koronavirusit.
Rastet u shënuan kryesisht te të rriturit e pavaksinuar dhe tek ata që janë vaksinuar më shumë se gjashtë muaj më parë.
Gjatë 24 orëve të fundit Izraeli ka regjistruar 2 886 raste të reja me Covid-19. Nga 602 personat që gjenden në spital, 348 janë të sëmurë rëndë.
Më shumë se 6 500 njerëz kanë vdekur në Izrael nga koronavirusi nga gati 900 000 raste të të infektuarve.

# Talibanët marrin nën kontroll një qytet kyç në veri të Afganistanit

KABUL, 8 GUSHT - Talibanët kanë marrë nën kontroll qytetin kyç verior të Afganistanit, Kunduz, një nga më të mëdhenjtë në vend, pas luftimeve të ashpra me forcat qeveritare. Një zyrtar lokal i tha "BBC"-së se i gjithë qyteti, përveç aeroportit, kishte rënë nën kontrollin e militantëve. Flamuri i talibanëve u pa i ngritur në qendër të qytetit. Deri më tani talibanët kanë marrë kontrollin e katër kryeqyteteve rajonale.
Zyrtarët afganë këmbëngulin se forcat e tyre ende janë të pranishme në këto qytete dhe se luftimet po vazhdojnë.
Talibanët po synojnë marrjen nën kontroll të qyteteve të mëdha, pasi kanë shtrirë kontrollin në shumë zona rurale.
Që nga data 6 gusht militantët morën kontrollin e tre kryeqyteteve të provincave, por marrja nën kontroll e kryeqytetit të provincës Kunduz, me rreth 375 000 banorë, është fitorja më e rëndësishme deri më tani.
Kunduzi konsiderohet si një portë për në provincat veriore të vendit.
Në aspektin strategjik është shumë i rëndësishëm pasi ka autostrada që e lidhin atë me qytetet e tjera të mëdha, përfshirë kryeqytetin Kabul. Aty gjendet edhe një kufi me Taxhikistanin.
Talibanët filluan një ofensivë kundër forcave qeveritare qëkur Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera, në muajin maj, filluan tërheqjen e forcave të tyre nga Afganistani, pas rreth 20 vjetësh të operacioneve luftarake atje.
Forcat e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara kanë rrëzuar talibanët nga pushteti në tetor të vitit 2001.
Talibanët kanë qenë duke strehuar atëbotë Osama Bin Ladenin dhe figura të tjera të Al-Kaidës, të lidhura me sulmet terroriste të 11 shtatorit të po atij viti në Shtetet e Bashkuara.
Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se tërheqja amerikane tani është e arsyeshme, pasi forcat amerikane janë siguruar që Afganistani nuk do të bëhet më bazë për xhihadistë të huaj që të kryejnë komplote kundër Perëndimit.



## Arabia Saudite do t'i lejojë të huajt të bëjnë pelegrinazh



Mekë, 8 gusht - Duke filluar nga 9 gushti, Arabia Saudite gradualisht do të fillojë të marrë kërkesa nga jashtë për pelegrinazhin Umra.
Por, kapaciteti do të jetë i kufizuar nga 60 000 pelegrinë në 2 milionë në muaj, njoftoi agjencia shtetërore e lajmeve SPA.
Ministria Saudite e Haxhit dhe Umrah ka njoftuar se pelegrinëve, në kërkesat e tyre do t'u kërkohet ta tregojnë certifikatën e autorizuar të vaksinimit kundër Covid-19.
Umra është një pelegrinazh që myslimanët mund ta bëjnë në çdo kohë.
Pelegrinët e huaj duhet t'i respektojnë masat e rrepta kundër koronavirusit para se ta kryejnë ritualin, përfshirë izolimin për tri ditë pas mbërritjes në Arabinë Saudite.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Sejdi Hoxha jep dorëheqje nga kryetari i Degës së PDK-së në Drenas

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 GUSHT - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Drenas, Sejdi Hoxha, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Ai lajmin e ka bërë me dije në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", në të cilin ka treguar arsyet e dorëheqjes.

Hoxha ka thënë se ishte i gatshëm të japë gjithçka nga vetja për ta mbajtur degën e PDK-së unike në këtë komunë por, sipas tij, kjo rezultojë të jetë e pamundur. "Ka shumë probleme të cilat i tejkalojnë kompetencat e mia si kryetar i degës. Për pasojë, erdhi deri te shpërthimi i shumë pakënaqësive të cilat tashmë janë të njohura për opinionin", ka thënë ai.

Hoxha ka drejtuar kritika edhe për udhëheqjen e PDK-së në Prishtinë. "PDK-ja në qendër e ka injoruar dhe e ka neglizhuar situatën e krijuar në Drenas duke mos e trajtuar me seriozitetin që e meriton, prandaj edhe duhet ta mbajë pjesën e përgjegjësisë për këtë situatë. Meqenëse problemet aktuale në degë tejkalojnë kompetencat e mia politike, unë në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë nuk do të lejoj qe dega të ndahet pak muaj para zgjedhjeve lokale, sepse kjo do t'u shërbejë vetëm konkurrentëve tanë politikë, askujt tjetër. Prandaj si zgjidhje e vetme e imponuar pa dëshirën time kam marrë vendim që të jap dorëheqje të parevokueshme nga pozita e kryetarit të Degës në Drenas", ka deklaruar Hoxha, i cili në mandatin e kaluar ka qenë edhe deputet i Kuvendit të Kosovës.




Ai ka thënë se aktivitetin politik në do ta vazhdojë në Këshillin Drejtues të PDK-së, anëtar i të cilit është. "Do të punoj për ta ngritur dhe për ta fuqizuar PDK-në ashtu siç e dëshirojnë qindra e mijëra aktivistë dhe simpatizantë të PDK-së në mbarë vendin", është shprehur Hoxha. Ai ka theksuar se lidershipi i PDK-së nuk duhet të shantazhohet para asnjë individi kushdo qoftë ai. Sipas Hoxhës, çdo vendim i marrë nën presion apo shantazh është vendim jo i drejtë dhe i dëmshëm për partinë, si dhe lëkund besimin e strukturave dhe të qytetarëve te lidershipi i PDK-së. "Besoj fuqishëm në kthimin e shpejtë të liderëve tanë nga Haga. Kthimi i tyre do të krijoj stabilitet më të madh politik dhe do ta fuqizojë PDK-në. Do të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë, duke respektuar kontributin dhe meritokracinë e secilit individ", ka thënë Sejdi Hoxha.

Kryetari aktual i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka reaguar në lidhje me dorëheqjen e Hoxhës. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se dorëheqja e Hoxhës nga kreu i Degës së PDK-së në Drenas nuk është lajm i mirë.

# Mehaj: Ushtria amerikane, garantuese e sigurisë në Kosovë



**Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka vizituar të dielën bazën ushtarake amerikane "Bondsteel" në Kosovë. Ai ka thënë se ushtria amerikane ishte dhe është garantuesja kryesore e sigurisë së Kosovës, si dhe garantuesja kryesore e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe global**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se ushtria amerikane ishte dhe është garantuese kryesore e sigurisë së Kosovës. "Ushtria amerikane ishte dhe është garantuesja kryesore e sigurisë së vendit tonë, si dhe garantuesja kryesore e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe global. Gjithçka që është ndërtuar, zhvilluar dhe avancuar në sistemin e mbrojtjes, sigurisë në vendin tonë në përgjithësi në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë se Kosovës, (FSK) në veçanti, i atribuohet rolit jetik dhe mbështetjes së pazëvendësueshme të ShBA-së dhe ushtrisë së saj", ka thënë Mehaj gjatë një vizite që i bëri të dielën bazës ushtarake amerikane "Bondsteel" në Kosovë.

Mehaj në këtë vizitë ishte i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, Rrahman Rama. Ministri Mehaj ka shprehur falënderimin dhe mirënjohjen më të lartë për SHBA-në, Departamentin e Mbrojtjes dhe kontingjentin amerikan të KFOR-it, për gjithçka që bën për lirinë, pavarësinë, ndërtimin, zhvillimin dhe përparimin e vendit tonë. "Në vizitën time, përveç falënderimit për mbështetje dhe për bashkëpunimin e ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, shpreha falënderimin dhe mirënjohjen edhe për angazhimin e pazëvendësueshëm të fundit të njësisë së helikopterëve për shuarjen e zjarreve", ka thënë ministri Mehaj.

Ushtarët amerikanë janë të angazhuar në kuadër të misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR, në Kosovë. Në maj të vitit 2021, trupat e FSK-së, së bashku me anëtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës së ShBA-së, u nisën në mision paqeruajtës në Kuvajt, që është misioni i parë jashtë vendit i kësaj force.

Në dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet ligjore për ta ndryshuar mandatin e FSK-së. Kësaj force është thënë se do t'i nevojitet një periudhë kohore prej dhjetë vjetësh për t'u transformuar në ushtri me kapacitete të plota. Qeveria e Kosovës është zotuar që në vitin 2022 do të ndajë mbi 100 milionë euro për FSK-në.



FLET PËR "EPOKËN E RE", ADRI NURELLARI

# PDK-ja do të ketë rimëkëmbje të shpejtë

Anëtari i Kryesisë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adri Nurellari, ka thënë se kjo parti do të jetë garanci e ekuilibrit demokratik kundrejt rrezikut të tiranisë së shumicës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se PDK-ja do të jetë ndërgjegjja e demokracisë së Kosovës. Sipas tij, opozitarizmi i PDK-së do të jetë zë i qytetarëve, zë i interesit të shtetit dhe interesit të kombit. Nurellari ka thënë se madhësisë së numrave të qeverisë PDK-ja do t'i përgjigjet me epërsi morale. Duke përmendur arsyet e angazhimit në këtë parti, ai është shprehur i bindur se PDK-ja do të ketë një rimëkëmbje të shpejtë

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 8 gusht -**

**"Epoka e re":** *Z. Nurellari, pse vendoset të bëheni pjesë e Kryesisë së PDK-së?*

**Nurellari:** E shikoj si hap të natyrshëm dhe logjik të radhës pas një dekade që jam i angazhuar si këshilltar politik pranë ish-kryetarëve të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veselit dhe Hashim Thaçit. Po ashtu, e shoh edhe si një hap të mëtejshëm të përfshirjes sime tashmë aktive në jetën shoqërore të Kosovës, përtej angazhimeve në media, shoqëri civile apo mësimdhënie. Jam mirënjohës për besimin që më ka dhënë lideri i opozitës, Memli Krasniqi, për t'iu bashkangjitur kryesisë së partisë dhe mezi pres ta dëshmoj veten se e kam merituar këtë besim. Unë mendoj se është edhe çështje përgjegjësie morale dhe akt fisnik që të angazhohesh në një parti në situatën e vështirë të opozitës sesa të aderosh duke iu servilosur pushtetit të ri sikurse po ndodh sot në Kosovë. Pra, besoj se një politikan i vërtetë e dëshmon veten më mirë në opozitë, ku mjetet e burimet janë shumë të kufizuara dhe ku kërkohet shumë më tepër idealizëm, kurajë dhe dedikim.

**"Epoka e re":** *Çfarë do të thotë për ju të jesh pjesë e kësaj partie politike?*

**Nurellari:** Unë e shikoj me kënaqësi e krenari që jam pjesë e një organizate politike e cila i ka rrënjët në luftën çlirimtare të Kosovës dhe u ka prirë proceseve më të rëndësishme të vendit, pavarësimit e shtetndërtimit. Mendoj se është parti e patriotizmit të vërtetë e jo atij tallava që mbizotëron sot në rrjetet sociale; e përgjegjësive politike shtetërore e jo e retorikës populiste sterile që ka marrë kontrollin e shtetit sot; e kurajës së ballafaqimit të problemeve e jo e neglizhimit e fshehjes; e partneritetit me ShBA-në dhe aleatët e tjerë perëndimorë dhe jo e frikës nga "thikat mbi harta" të Shtëpisë së Bardhë, e vizionit largpamës e projekteve të mëdha e jo e debateve shterpe moraliste pa produktivitet si ato që po shohim vitet e fundit. PDK-ja është parti e qendrës së djathtë që gjatë shtatë vjetëve që ka udhëhequr qeverinë e ka bërë Kosovën të citohet çdo vit nga Banka Botërore si reformatorja më e mirë duke mbajtur një mesatare të rritjes ekonomike më të lartën në rajon. Prandaj, unë ndihem si në shtëpinë time në këtë parti dhe, pavarësisht prej shumë problemeve që ka pasur, ka e do të ketë, unë jam i sigurt që kjo parti siguron ofertën më të mirë për interesat e Kosovës dhe mirëqenien e qytetarëve të saj.

**"Epoka e re":** *Sfida e parë e kryetarit dhe kryesisë së re të PDK-së do të jenë zgjedhjet lokale. Si e shihni paraqitjen e kësaj partie në këto zgjedhje?*

**Nurellari:** Unë jam optimist se do të ketë një rimëkëmbje të shpejtë. Së pari, një herë rifreskimi i strukturave drejtuese e ndryshon ndjeshëm imazhin publik të PDK-së. Duhet pranuar që konsumi i pushtetit si dhe gabime apo pakujdesi të ndryshme që mund të jenë bërë gjatë qeverisjes së PDK-së e kanë dëmtuar popullaritetin, prandaj prurja e figurave të reja pa hipotekë prej së kaluarës e riparon këtë kosto. Shkuarja në Hagë e dy ish-kryetarëve, Veseli e Thaçi, mandej qe një tërmet i rëndë nga i cili mezi po e marrim veten. Unë mendoj se Partia Demokratike e Kosovës ka paguar edhe një kosto tepër

të madhe e të pamerituar për shkak të përgjegjshmërisë dhe kurajës që ka treguar duke u ballafaquar me problemet e rënda e të pakëndshme të vendit. Rasti më domethënës është dialogu, ku PDK-ja është treguar e vetëdijshme se ajo temë është e domosdoshme për t'u ballafaquar pavarësisht se nuk është aspak temë popullore. Ndryshe nga mënyra se si po vepron Kurti që po i shmanget gjithmonë kësaj përgjegjësie, duhet thënë se shumë aktorë politikë janë bashkuar me retorikën e zërave dashakeqë të huaj, duke u treguar nihilistë e mohues ndaj arritjeve të deritanishme të Kosovës dhe kanë ushqyer pritshmëri të ekzagjeruara dhe aspirata jorealiste te qytetarët të cilat shkaktuan një pakënaqësi të paarsyeshme ndaj partisë sonë.

Tashmë që PDK-ja prej vitesh nuk e ka kryeministrin, po bëhet gjithnjë e më e qartë se vendi është në stanjacion të plotë, për mos të thënë në regres. Prandaj unë jam i bindur që brenda një kohe të shkurtër magjepsja me populizmin e Kurtit do të zbehet e gjithnjë e më shumë qytetarë do të ndërgjegjësohen se kjo qeveri jo vetëm nuk i përball dot sfidat që Kosova ka përpara, por edhe detyrat e përditshme të qeverisjes nuk di t'i bëjë mirë. Gjithnjë e më shumë qytetarë të Kosovës po vetëdijesohen se modeli i qeverisjes së PDK-së padyshim që nuk është i përsosur e ka të meta, por ama është më rezultativ e i përgjegjshëm se modelet e qeverisjes nga kryeministra të LDK-së, të AAK-së e, së fundmi, të LDK-së. Për mos të folur mandej që rezultatet e qeverisjes lokale të LV-së, në Prishtinë, Prizren e Mitrovicë, kanë qenë katastrofale dhe vështirë që magjia e popullaritetit të Kurti ta mbulojë shijen e hidhur me dështime, mashtrime, skandale e abuzime që ka lënë te qytetari.

**"Epoka e re":** *Po ndaj qeverisë, cila duhet të jetë qasja e lidershipit të ri të kësaj partie?*

**Nurellari:** Opozita ka një rol thelbësor në demokraci duke luajtur rolin e kundërpeshës, kontrolluesit dhe mbrojtësit të demokracisë dhe në këtë aspekt PDK-ja do të jetë garancia e ekuilibrit demokratik kundrejt rrezikut të tiranisë së shumicës. Prandaj, ajo do ta mbikëqyrë qeverinë dhe administratën shtetërore për ta rritur llogaridhënien në të gjitha proceset politike, duke siguruar një menaxhim sa më të mirë të parave të taksapaguesve. Ajo jo vetëm që do të mbajë një qëndrim kritik e do të bëjë presion për transparencë në qeverisje, por edhe do të luajë një konstruktiv, cilësor dhe proaktiv, duke krijuar një kontrast të qartë nga modeli opozitar obstruktiv dhe i dhunshëm i LV-së gjatë kohës që ajo ishte në opozitë.

**"Epoka e re":** *Numri i deputetëve të PDK-së në Kuvend mund të jetë problem për ta bërë opozitën e duhur?*

**Nurellari:** Unë mendoj se edhe pse ka pak numra në Kuvend, PDK-ja do të jetë ndërgjegjja e demokracisë së Kosovës duke shërbyer si zëri i qytetarëve, zëri i interesit të shtetit, interesit të kombit. Madhësisë së numrave PDK-ja do t`i përgjigjet me epërsi morale, sasinë do ta ballafaqojë me cilësi. Qeveria e sotshme, duke siguruar edhe pozitën e presidentit falë flirtimit të një pjese të opozitës, është më e fuqishme se asnjëherë më parë. Ky përqendrim kaq i madh i pushtetit në një dorë kërcënon demokracinë e sundimin e ligjit në Kosovë. Lordi Acton thoshte: pushteti absolut korrupton në mënyrë absolute. Prandaj në kushtet e tendencave gjithnjë e më të theksuara autoritare e arbitrare të qeverisë Kurti, PDK-ja është partia e vetme që është barrierë ndaj këtij lideri populist. Nëse të gjitha partitë e tjera parlamentare kanë bashkëpunuar ngushtë me Kurtin, i janë nënshtruar atij apo në rrethana të caktuara kanë hyrë në agjendën e tij anti-institucionale apo anti-perëndimore, PDK-ja është e vetmja parti që ka qëndruar koherente e konsistente në qëndrimin shtetndërtues properëndimor. Prandaj, PDK-ja do të vazhdojë të punojë që t'i mbrojë arritjet dhe orientimin e deritanishëm nga kërcënimi i atyre që mohojnë gjithçka të kaluar dhe pretendojnë se historia nisi kur ata hipën në pushtet. Kjo do të thotë që do të punojë në opozitë për të pasur një Kosovë demokratike, me sundim ligji, ekonomi tregu e prone private, me liri individuale, liri fjale e mendimi, me partneritet të ngushtë me aleatët, me orientim gjeopolitik properëndimor, me respekt për pronën private dhe ekonominë e tregut, me luftë kundër ndikimit të Beogradit e elementeve ish-jugosllave në Prishtinë etj.

# Çështje ditësh, zyrtarizimi i kandidaturave të LV-së për zgjedhjet lokale




Lëvizja Vetëvendosje shumë shpejt do ta bëjë zyrtarizimin e kandidatëve për kryetar të komunave në zgjedhjet lokale. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi, ka thënë se kjo parti është ende në shqyrtim të kandidaturave dhe se zyrtarizimi i tyre është çështje ditësh. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë me dije se për pjesëmarrje në zgjedhjet e 17 tetorit deri më tani kanë aplikuar tetë subjekte politike

PRISHTINË, 8 GUSHT - Partitë politike në Kosovë po vazhdojnë t'i publikojnë emrat e kandidatëve për kryetar të komunave për zgjedhjet lokale që pritet të mbahen më 17 tetor, përveç partisë në pushtet e cila ende nuk e ka bërë publik asnjë prej emrave me të cilët synon t'i hyjë garës.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi, ka deklaruar se kjo lëvizje është ende në shqyrtim të kandidaturave. Ai ka bërë me dije se publikimi i emrave për secilën komunë është çështje ditësh. "Ne jemi në kuadër të procesit të zgjedhjeve të brendshme të kandidatëve për kryetar komunash. Jemi në mes të këtij procesi. Tashmë ato po shqyrtohen nga kryesia qendrore para se të kalojnë për t'u votuar nëpër këshillat e qendrave. Besoj se është çështje ditësh kur do të publikohen kandidaturat për secilën komunë. Natyrisht do të jenë kandidatë që do të mundësojnë fitoren e madhe të Vetëvendosjes edhe më 17 tetor", ka thënë Rrustemi për "Kosovapress".

Ndërsa Bekim Salihu nga Instituti GAP ka theksuar se deri më tani partitë do të duhej t'i kishin të qarta listat me kandidatë me të cilët synojnë t'i hyjnë garës për zgjedhjet lokale. "Besoj se janë dy arsye pse partitë politike nuk i kanë nominuar në tërësi disa kandidatë, ose kandidate për kryetar komunash. Arsyeja e parë është fakti se partitë politike bëjnë sondazhe dhe e matin opinionin publik se cili kandidat ose kandidate potencicale mund të ketë avantazh në terren dhe, ndoshta, janë duke i pritur rezultatet e fundit në këtë drejtim. Arsyeja e dytë e cila mund të jetë më e rëndësishme se kjo e para, ka të bëjë me moskonsensusin e brendshëm partiak se kush do ta udhëheqë garën nëpër komuna, pra partitë politike në disa raste në disa komuna kanë treguar ose kanë reflektuar mospajtime të brendshme lidhur me emrat potencialë që përmenden për të qenë udhëheqës të garës për të marrë pozitën e kryetarit të komunës", ka deklaruar Salihu.

Deri më tani në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë aplikuar vetëm tetë subjekte politike. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar se nga këto subjekte, pesë janë iniciativa qytetare, një parti politike dhe dy kandidatë të pavarur. "Është duke vazhduar periudha e aplikimit të subjekteve politike për t'u certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale të 17 tetorit si dhe për dorëzimin e listës me emrat e kandidatëve për kryetar komune apo për kuvende komunale. Kjo periudhë përfundon më 16 gusht. Deri më tani kemi pranuar 8 aplikime të subjekteve politike, prej tyre 5 iniciativa qytetare, 1 parti politike dhe 2 kandidatë të pavarur", ka thënë Valmir Elezi.

Zgjedhjet lokale në Kosovë pritet të mbahen më 17 tetor të këtij viti. Për këto zgjedhje do të mbahet fushatë zgjedhore 30 ditë.

# Rreth 2 000 raste aktive me Covid në Kosovë, bëhet thirrje për vaksinim



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 8 gusht** - Të dielën në Kosovë janë regjistruar 269 raste të reja me Covid-19, bazuar në 4 492 mostra të testuara, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Më së shumti të infektuar janë regjistruar në Prishtinë, 63, pasuar nga Ferizaj me 25 dhe Podujeva me 24 të infektuar. Sipas raportit ditor, më së shumti raste janë shënuar në grupmoshën 20-29 vjeç, përkatësisht 76 raste.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të shëruar nga sëmundja Covid-19 janë regjistruar edhe 25 pacientë, ndërsa raste aktive janë 1 903.

Që prej 13 marsit të vitit 2020 deri më 8 gusht 2021 Kosova ka regjistruar gjithsej 109 931 raste me Covid-19, viktima 2 271, ndërsa 105 757 pacientë janë shëruar. Më herët, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) u bëri thirrje qytetarëve që t'i përgjigjen fushatës së imunizimit kundër Covid-19. "Me vaksinim do ta kalojmë valën e re nga varianti Delta me sa më pak të sëmurë e sa më pak viktima", thuhet në një postim të IKShPK-së në rrjetin social "Facebook".

Varianti 'Delta' është shumë më ngjitës dhe po dominon në mbarë botën. "Disa po ngurrojnë për t'u vaksinuar sepse frikësohen nga efektet anësore të cilat deri tani në Kosovë kanë qenë minimale, por dobia e mbrojtjes nga Covid-19 është shumë herë më e madhe", ka njoftuar IKShPK-ja.

Që prej fundit të marsit të vitit 2021, kur nisi procesi i vaksinimit, në Kosovë janë administruar mbi 480 mijë doza të vaksinës.

Në Kosovë qytetarët mund të zgjedhin nëse duan të vaksinohen me vaksinën 'AstraZeneca' apo 'Pfizer'.

Qeveria e Kosovës mëton që deri në fund të këtij viti të imunizojë kundër Covidit 60 për qind të popullatës.

# Drejtori i Policisë e sheh të nevojshëm vetingun

**Prishtinë, 8 gusht** - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, e ka vlerësuar të nevojshëm procesin e vetingut në sistemin e sigurisë, përfshirë edhe Policinë e Kosovës. Mehmeti ka thënë se vetingu do të ndikonte që qytetarët të kenë më shumë besueshmëri në këto institucione. "Një veting do ta ngrehte besueshmërinë te qytetarët. Për ne absolutisht është i mirëseardhur", ka thënë Mehmeti në një intervistë për emisionin "Betimi për drejtësi". Vetingun po e shtynë përpara edhe Ministria e Drejtësisë. Ky proces shërben për përjashtimin e zyrtarëve publikë që nuk kanë integritet për përmbushjen e detyrës në mënyrë që të rikthehet besimi i publikut në punën e institucioneve shtetërore.






# Kryetari Jashari përkujton dëshmorin Abedin Vojvoda

**Skenderaj, 8 gusht (ER)** - Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka përkujtuar në 23-vjetorin e rënies dëshmorin Abedin Vojvoda nga fshati Llaushë. Ai së bashku me shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, drejtorë e asamblistë, vendosen lule dhe nderuan lart luftën dhe sakrificën e dëshmorit Vojvoda.

Kryetari Jashari ka thënë se Abedin Vojvoda u vu në shërbim të atdheut duke dhënë më të shtrenjtën jetë për lirinë e vendit. "Rënia e tij heroike dhe e dëshmorëve të tjerë në emër të lirisë së vendit janë amaneti ynë që të punojmë me nder dhe përgjegjësi për mirëqenie dhe prosperitet për të gjithë", ka thënë Bekim Jashari.

# Mbi 50 mijë qytetarë të Kosovës drejt Shqipërisë për fundjavë

**Prishtinë, 8 gusht** - Më shumë se 50 mijë qytetarë të Kosovës u nisën drejt Shqipërisë këtë fundjavë, ndërsa e diela ka nisur me një fluks të lartë makinash në Morinë. Policisë kufitare iu desh që të punonte me kapacitete shtesë e procedurë të përshpejtuar. Shumë prej qytetarëve të Kosovës kanë kërkuar zbatim praktik dhe shmangie të vonesave, ndërsa ka prej tyre që duan edhe heqjen e traut në Rrugën e Kombit. Por radhët e gjata të automjeteve, si pasojë e fluksit të lartë, nuk krijohen vetëm në Morinë. Një tjetër segment problematik i Rrugës së Kombit është tek Ura e Drinit në hyrje të Kukësit. Radhë dhe vonesa krijohen edhe si pasojë e ngushtimit të rrugës me një sens lëvizje. Policia rrugore e stacionuar pranë këtij segmenti është duke menaxhuar trafikun për përpjekje për ta lehtësuar qarkullimin.



# Blloqet nga Serbia 'shkatërrojnë' kompanitë në Kosovë!



PRISHTINË, 8 GUSHT - Heqja e taksës nga Qeveria e Kosovës për blloqet e argjilës për ndërtim, të prodhuar në Serbi, do të ndikojë në zvogëlimin e sasisë së prodhimit të këtij produkti nga kompanitë vendore, thonë pronarë të disa kompanive prodhuese të materialeve ndërtimore. Sipas tyre, me shfuqizimin e kësaj mase blloqet me origjinë nga Serbia do të hyjnë më lirë në tregun e Kosovës për rreth 10 për qind të çmimit. Qeveria e Kosovës ka shfuqizuar një vendim të vitit 2016 për masat mbrojtëse antidamping prej 0.02 centësh për blloqet standarde 19x19x25 të importuara nga shteti i Serbisë.

Dampingu nënkupton importin e mallrave në Kosovë, me një çmim më të ulët të eksportit sesa çmimi i krahasueshëm për produktin e ngjashëm të destinuar për konsum në kushtet normale të tregut në vendin eksportues.

Shfuqizimi i kësaj mase për prodhuesit vendorë të materialeve ndërtimore, përveç zvogëlimit të sasisë së prodhimit, do t'i ndërpresë edhe investimet e reja, thotë Ilir Dula, zëvendësdrejtor në kompaninë "Rizam Holding" në Prizren.

"Rizam Holding" aktualisht prodhon 12 milionë blloqe gjatë një viti dhe ka 75 punëtorë. "Ka ndikim negativ sepse po dëmtohemi, pasi Serbia ka subvencione nga shteti i vet dhe ka mundësi që të prodhojë edhe për tregun e Kosovës. Me këto masa ne jemi mbrojtur. Tash pas heqjes neve na shkatërron investimet që i kemi bërë vetë, e mos të flasim për investimet e reja. Normalisht që numri i blloqeve do të zvogëlohet sepse tregtari që ka depo materiali, furnizohet me çmime më të ulëta dhe njerëzit i blejnë me çmim më të lirë, nuk i intereson prodhuesi", tha Dula.

Çmimi i një blloku ndërtimor me shumicë kushton rreth 22 centë, varësisht nga kompania prodhuese, ndërsa me pakicë deri në 25 centë.

Përveç uljes së sasisë së prodhimit të blloqeve ndërtimore, rrezikohet edhe ulja e numrit të punëtorëve, thotë Ejup Maloku, pronar i kompanisë "Apollonia". "Neve na detyrojnë për këto, sepse kompanitë serbe na pengojnë në shitje. Kur nuk shiten, mbushen depot dhe duhet ta zvogëlojmë prodhimin. Kur nuk shitet produkti, ndikon në numrin e punëtorëve dhe pagat e tyre", tha Maloku për "Radion Evropa e Lirë".

Edhe kryetari i Shoqatës së Prodhuesve të Materialit Ndërtimor nga Argjila, Mustafë Borovci, njëherësh pronar i kompanisë "Brickos" në Gjilan, shprehet se me shfuqizimin e kësaj mase prodhuesit vendorë i vë në konkurrencë të ashpër me prodhuesit e Serbisë, të cilët, sipas tij, subvencionohen në forma të ndryshme nga shteti i tyre. Borovci thotë se gjatë pesë vjetëve sa ka qenë në fuqi kjo masë, është përmirësuar dukshëm situata financiare e kësaj industrie. Sipas Borovcit, në Kosovë operojnë tetë kompani për prodhimin e blloqeve ndërtimore me rreth 1 200 punëtorë. "Blloku i Serbisë do të jetë më i lirë për 0.02 centë në tregun e Kosovës. Kjo do të reflektojë shumë, sepse për të kuptuar vlerën e 0.02 centëve është rreth 10 për qind e vlerës së një blloku. Meqë një pjesë e tregut të Kosovës i jepet një vendi fqinj dhe rrezikohen disa nga prodhuesit vendorë të blloqeve, mendoj se ky është tregues i mjaftueshëm për rëndësinë që masa të mbetet në fuqi. Nuk di se pse duhet të mirëmbahet industria e një vendi fqinj dhe të rrezikohet e industria e Kosovës", tha ai.

Ndërkaq Boban Markoviq, drejtor në kompaninë e blloqeve "Mladost" nga Leskovci, thotë se kur është vendosur taksa prej dy centëve, vite më parë, uli ndjeshëm vëllimin e shitjeve të produkteve tyre në Kosovë. Taksa 100 për qind pastaj e ndërpreu eksportin e tyre në Kosovë, kështu që kjo kompani u detyrua të kërkojë disa tregje të reja për të zëvendësuar tregun e Kosovës. "Me heqjen e taksës 100 për qind, taksa prej 2-centësh mbeti dhe vazhdoi të ketë një efekt destimulues në shitjen e produkteve tona në vitin e kaluar. Për momentin, heqja e taksës do të thotë shumë, por ne nuk mund ta dimë efektin e saktë. Do ta dimë efektin vitin e ardhshëm, kur do të bëjmë kontrata dhe do të planifikojmë mallra më të mëdha për këtë treg, pasi nuk ka më barriera administrative për eksportet", thotë Markoviq për "Radion Evropa e Lirë".

Në sqarimin publik të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë për shfuqizimin e kësaj mase, thuhet që, sipas Ligjit për masat antidamping dhe kundërbalancuese, "çdo detyrim përfundimtar antidamping apo kundërbalancues duhet të skadojë, pas një maksimumi prej pesë vjetësh nga vendosja e tij". "Duke i marrë parasysh të gjitha këto veprime, është shfuqizuar vendimi, sepse më 07.07.2021, sipas afateve ligjore, janë bërë pesë vjet të zbatimit të kësaj mase", thuhet në sqarimin e MTI-së.

Shoqata e Prodhuesve e Materialit Ndërtimor nga Argjila ka dërguar kërkesë në Ministri të Tregtisë, që masa antidamping të vazhdohet, tregon Borovci. "Pas shfuqizimit të vendimit, ne kemi dërguar kërkesën më 28.07.2021 për vendosjen e masës së re. Po shpresojmë se ata do të analizojnë edhe një herë këtë punë dhe të vendosin një masë tjetër e cila mund të jetë aq sa ka qenë në pesë vjetët e fundit apo edhe më e lartë. Kërkesa jonë është që ajo të jetë 0.02 centë e më lartë për një bllok", thotë Borovci.

Masat mbrojtëse janë të domosdoshme, vlerëson edhe kryetari i Odës së Afarizmit, Skënder Krasniqi. "Në këtë rast, qeveria duhet me urgjencë ta analizojë efektin që mund të ketë heqja e kësaj mase, sepse mund të dëmtojë shumë këtë sektor i cili e ka marrë veten falë mbrojtjes që i ka bërë shteti para pesë vjetësh. Dhe në rast se shfuqizimi i vendimit po dëmton bizneset, qeveria ose duhet t'i përkrahë në mënyrë financiare këto biznese, apo të fillojë zbatimin e masave antidamping", shprehet ai.

Në ministri thonë se janë duke e përcjellë për së afërmi sektorin e prodhimit të materialit ndërtimor me bazë argjilore dhe se janë duke analizuar importin dhe çmimet e shitjes së produktit në fjalë nga Serbia dhe se së shpejti do të dalin me analiza konkrete. Nëse konstatohet se vazhdon çmimi damping në tregun e Kosovës, ministria do të vendosë përsëri masën mbrojtëse për blloqet nga Serbia.

Ndaj largimit të masës mbrojtëse për materialet ndërtimore nga Serbia kanë reaguar edhe partitë opozitare. Sipas tyre, është i papranueshëm arsyetimi i qeverisë se afati i vendimit të vitit 2016 ka skaduar dhe se do të bëjnë një hetim tjetër për të vendosur prapë këtë masë.

# Berisha: Kosova duhet t'i marrë shembull shtetet e tjera për uljen e çmimit të biletave të avionit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ish-drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, Eset Berisha, ka thënë se është për t'u çuditur se si nuk po ulen çmimet e biletave të avionit edhe përkundër numrit të madh të kompanive ajrore. "Është për t'u çuditur që, edhe përkundër numrit të madh të kompanive ajrore, prapë ka ankesa të udhëtarëve për bileta të shtrenjta. Pra, konkurrenca nuk po e ul çmimin e biletave. Këtu duhet pasur parasysh se secila kompani ajrore paguan shërbimet e njëjta për të arritur në Prishtinë dhe për të fluturuar nga Prishtina në drejtim të qyteteve evropiane", ka thënë Berisha për gazetën "Epoka e re".
Ai ka theksuar se për shkak të mbylljes së korridorit të Malit të Zi që nga viti 1999, të gjitha fluturimet që kanë destinacion Kosovën duhet të qarkullojnë përmes Shqipërisë dhe Maqedonisë për të hyrë e dalë nga hapësira ajrore e Kosovës. E kjo, sipas tij, ka ndikim edhe në çmimin e biletave. "Në vitin 2019 AAC-ja dhe Qeveria e Kosovës kishte pranuar një zotim të qartë të NATO-s se ky korridor do të hapej në fund të vitit 2020. Marrëveshja për fluturimin e kompanisë ajrore gjermane Prishtinë - Beograd vetëm sa e forconte vullnetin e autoriteteve malazeze për ta lejuar hapjen e këtij korridori, duke marrë parasysh se hapësira ajrore mbi 5 000 metra e Malit të Zi kontrollohet nga ndërmarrja e përbashkët serbo-malazeze me qendër në Beograd", ka thënë Berisha.
Ai ka theksuar se me hapjen e këtij korridori do të shkurtohej çdo fluturim për në Kosovë për rreth 30 minuta. "Po ashtu, nuk do të paguhen taksa për shërbime në hapësirën ajrore të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, të cilat vetëm e rëndojnë koston e kompanive ajrore", ka thënë Berisha. Ai ka thënë se tregu i fluturimeve në Republikën e Kosovës është i hapur për të gjitha kompanitë ajrore të regjistruara në BE. Sipas Berishës, shteti ka mekanizma për të adresuar këtë problem të pazgjidhur që nga paslufta. "Nëse nuk kanë njohuri, le t'i shohin shtetet e tjera. Për shembull, Maqedoninë e Veriut se si ka arritur t'i ulë çmimet e biletave. Ka rritur numrin e udhëtarëve dhe ka kontribuar dukshëm edhe në rritjen e produktit vendor. Maqedonia e Veriut ka zbatuar dy programe katërvjeçare me të cilat ka subvencionuar drejtpërdrejt kompanitë ajrore me pagesa për çdo udhëtar. Edhe Kosova ka pasur një iniciativë të tillë në vitin 2019", ka thënë Berisha.
Ai ka treguar se Ministria e Infrastrukturës në atë kohë kishte propozuar një plan për subvencionim të kompanive ajrore të cilat rritin numrin e udhëtarëve për çdo vit me një kosto prej 5 milionë eurosh. "Ky propozim u refuzua nga Ministria e Financave kinse bie ndesh me rregullat e ndihmës shtetërore të BE-së. Për dallim prej Kosovës, Maqedonia e Veriut ka status më të avancuar në raport me BE-në, por nuk ngurroi të bie 'ndesh' me këto rregulla për shkak të nevojës për rritje të numrin të udhëtarëve", ka thënë Berisha. Ai ka theksuar se për ta ndryshuar gjendjen e tanishme në Aviacionin Civil të Kosovës duhet vullnet, përkushtim dhe dituri për të manovruar brenda rregullave të lejueshme të BE-së.





# Aeroporti i Gjakovës, ende jashtë funksionit

GJAKOVË, 8 GUSHT - Po bëhen shtatë vjet prej kur Qeveria e Kosovës kishte krijuar ndërmarrjen publike "Aeroporti i Gjakovës", i cili ka mbetur jashtë funksionit edhe sot.
Aeroportin e Gjakovës e ndërtoi KFOR-i italian për qëllime ushtarake dhe i cili deri në vitin 2013 është përdorur në mbështetje të aktiviteteve ushtarake për aeroplanët e operacioneve të misionit të NATO-s, ndërsa transformimi te autoritetet e Kosovës ishte bërë në vitin 2013, pas një marrëveshjeje të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Italisë dhe Qeverisë së Kosovës.
Sot përdoret për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes.
Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë për "KosovaPress" se problemet me funksionalizimin e Aeroportit të Gjakovës datojnë nga viti 2011, me vendimin për koncensionimin e Aeroportit "Adem Jashari". Ai ka thënë se kontrata për koncensionimin e Aeroportit "Adem Jashari" e ka pamundësuar hapjen në këtë fazë të Aeroportit të Gjakovës.
Gjini ka thënë se pista e këtij aeroporti është e njëjtë me Aeroportin e Prishtinës. "Ky aeroport i plotëson të gjitha kushtet për ngritje dhe aterrim", ka thënë kryetari Gjini. Megjithatë, nga partia në pushtet thonë se në plan të tyre kanë funksionalizimin e Aeroportin të Gjakovës. Ushtruesja e detyrës e shefes së grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se tashmë e kanë një plan dinamik i cili mund ta kthejë një pjesë të funksionit dhe ta bëjë aeroportin si pikë reference për qytetarët e asaj zone jo vetëm për Kosovë, por edhe për Shqipëri.
Në një përgjigje me shkrim të Ministrisë së Mbrojtjes për "KosovaPress", bëhet me dije FSK-ja e shfrytëzon hapësirën e Aeroportit të Gjakovës varësisht nga nevojat për aktivitetet stërvitore.





MARK TWAIN

# KANDIDAT PËR PRESIDENT

Them se e kam ndarë mendjen të kandidoj për t'u bërë president. Ajo për çfarë vendi ka nevojë është një kandidat që nuk e dëmton dot kur hidhet dritë në të shkuarën e tij dhe armiqtë e partisë s'janë në gjendje t'i nxjerrin faqe botës bëmat për të cilat s'i kishte shkuar mendja kujt. Nëse, që në fillim fare i dinë të gjithë edhe më të këqijat e një kandidati, më pas çdo përpjekje për të bërë bujë me ndonjë të pabërë të panjohur nuk ka kurrfarë pasoje. Ja pra, po hyj në garë me letra të hapura. U dal zot paraprakisht të gjitha poshtërsive që kam bërë dhe, nëse ngrihet ndonjë komision hetimor në kongres të gërmojë në biografinë time për të zbuluar ndonjë vepër të errët dhe të tmerrshme që e kam mbajtur të fshehtë, pse jo, le të gërmoj.

Në radhë të parë, e pranoj që në dimrin e vitit 1850 kam detyruar të hip majë peme një gjysh timin që vuante nga reumatizma. Ishte i moshuar dhe pa përvojë në ngjitjen e pemëve, por ngaqë jam i pashpirt, tipar dallues i natyrës time e detyrova që ashtu siç ishte, me teshat e gjumit, t'ia mbath me vrap nga dera e përparme, nën shoqërinë e qytës së pushkës, dhe të kacavarej nëpër trungun e një panje, ku dhe mbeti gjatë gjithë natës, ndërsa e qëlloja nga këmbët. Këtë e bëra sepse ai gërhiste. Dhe do ta bëja përsëri po të kisha një gjysh tjetër. Unë jam sot po aq çnjerëzor sa isha më 1850.

E pranoj me sinqeritetin më të madh se ia mbatha nga sheshbeteja e Getinsburgut. Miqtë janë përpjekur të ma lehtësojnë këtë rrethanë duke pohuar se e bëra me qëllimin e vetëm për ta imituar Xhorxh Uashingtonin i cili vajti në pyllin e Valley Forge me qëllim që të lutej. Ajo që bëra unë ishte thjesht një dredhi e mjerë. Vija ime e tërheqjes përkonte më atë të Tropikut të Gaforres sepse u tremba. Dëshiroja që vendi im të shpëtonte, por parapëlqeja që dikush tjetër ta shpëtonte në emrin tim. Ky parapëlqim vazhdon ta gëzojë mbështetjen time edhe sot. Nëse lavdia e përkohshme mund të sigurohet vetëm duke dalë para grykës së topit, shpreh vullnetin tim t'i dal para, por me kusht që topi të mos jetë i mbushur. Nëse topi është plot me gjyle, qëllimi im i pavdekshëm dhe i paepur është ta kapërcej gardhin dhe ta mbaj frymën për në shtëpi. Praktika ime e pandryshueshme në luftë ka qenë gjithmonë që prej saj të dalin gjallë më shumë se dy të tretat e luftëtarëve të fillimit. Kjo mua më duket akt heroik napoelonik në madhë¬shtinë e vet.

Pikëpamjet e mia financiare janë më se të përcaktuara, por ato nuk kanë gjasa, ndoshta, të ma shtojnë popullaritetin ndër avokatët e inflacionit. Nuk këmbëngul aspak për epërsinë e veçantë të parasë në dorë kundrejt përfitimeve në natyrë. Parimi kryesor themelor i jetës time është kap ç'të kapësh, çfarëdo qoftë ajo. Thashethemet se kam varrosur një nga tezet e vdekura nën hardhi janë korrekte. Hardhia kishte nevojë të plehërohej, tezja duhej të varrosej, dhe unë ia blatova atë këtij qëllimi të lartë. A më bën kjo të papërshtatshëm për Presiden¬cën? Kushtetuta e vendit tonë nuk thotë kështu. Asnjë qytetar nuk është parë ndonjëherë si i padenjë për këtë post ngaqë pasuroi rrënjët e hardhisë me lëndët ushqyese të një të afërmi të vdekur. Pse u dashka të jem viktima e parë e një paragjy¬kimi absurd? E pranoj, gjithashtu, që nuk jam mik i të varfërve. Unë e shoh të varfrin në gjendjen e tij të tanishme, si lëndë e parë e konsumuar tej mase. I grirë dhe i konservuar si duhet, i varfëri mund të jetë i dobishëm për të majmur vendasit në ishujt ku ka kanibalë si dhe për ta përmirësuar eksportin tregtar në atë zonë. Nxjerrjen e ligjeve përkatëse për këtë çështje do ta rekomandoj që në fjalimin tim të parë drejtuar kombit. Parulla e fushatës time do të jetë: Të grihet punëtori i pabukë, mish i thatë për suxhuk.

Këto janë gjërat më të këqija të së shkuarës time. Pavarësisht nga kjo, kërkoj besimin e vendit tim. Nëse vendi im s'më do, do ta vazhdoj jetën që kisha më parë. Por unë e rekomandoj veten për president si dikush të cilit mund t'i besoni, si dikush i cili mbështetet te poshtërsia si veçoria e tij themelore dhe propozon të jetë maskara deri në fund.

**(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Granit Zela)**

# Të gjesh të njerëzishmen dhe përulësinë tek Alberto Giacometti

**Gunnhild ØYEHAUG mbi një nga skulptorët më të mëdhenj të shekullit XX**

Ka kaluar një kohë shumë e gjatë që kur zvicerani Alberto Giacometti dhe vëllai i tij, Diego, çuan një karrocë dore me sendet e tyre për në Paris, ku ai filloi një jetë të re si skulptor në një studio, e cila me kalimin e kohës u bë gjithnjë e më e rrëmujshme, e mbushur me gjithnjë e më tepër skulptura (përfytyroj unë) (por kam parë edhe fotografi të saj), ku, për ca kohë, ai u frymëzua veçanërisht nga surrealizmi, por më pas iu kthye skulpturave tradicionale, për neverinë e André Breton, i cili e talli: "Të gjithë e dinë se ç'pamje ka një kokë" – ka kaluar vërtet shumë kohë që kur ai jetoi jetën që solli kaq shumë skulptura – sepse edhe pasi ai flaku shumë prej tyre, vazhdoi të prodhonte të tjera, ca të mëdha, ca tejet të vogla, të gjitha shumë të holla – e që gjithashtu solli kaq shumë tekste dhe libra mbi Giacometti-n dhe skulpturat e tij (ja dhe një tjetër) – ka kaluar një kohë jashtëzakonisht shumë e gjatë nga atëherë e deri te momenti kur unë përulem përpara diçkaje që më kap syri, ndërkohë që eci përgjatë një korridori të ngushtë në Muzeun e Artit Modern të Luizianës, në kërkim të një dhome ku do të zhvillohet një ngjarje letrare, saqë të krahasosh distancën ndërmjet asaj kohe dhe tani me, për shembull, distancën mes tokës dhe hënës, thjesht nuk është e mjaftueshme, sepse hapësira ndryshon nga koha.

Asgjë nuk është aq e pamëshirshme dhe e pakapërcyeshme sa koha, ndoshta prandaj asnjëra nga këto – as mbërritja e Giacometti-t në Paris, as rraskapitja e tij e përditshme me skulpturat përgjatë gjithë jetës, ecejaket lart e poshtë studios së tij, zhvillimi i tij artistik, rutina e tij e përditshme apo pamja nga dritarja – nëse kishte të tillë – ku ndoshta shihte pëllumbat teksa uleshin në ndonjë çati aty pranë, asgjë nga këto nuk kishte rëndësi ndërkohë që unë nxitoj nëpër korridor. Nuk orientohem dot, e mendoj se te një nga dhomat përtej ekspozitës së Giacometti-t po zhvillohet një aktivitet me Sally Rooney-n, por nuk kisha ndërmend të ndaloja, dhe këto lëvizjet e mia përmes korridoreve të Muzeut të Artit Modern të Luizianës do të kishin humbur nëse nuk do të kisha shkruar për to këtu – por le të kthehemi te Giacometti. E kisha parë Giacometti-n më përpara, e bashkë me Yves Klein dhe Anselm Kiefer i përkasin një periudhe të jetës sime që unë e quaj rini, por që është në fakt periudha e shkurtër mes moshës 20 dhe 23 vjeç, kur zbulova, me gjithë intensitetin e rinisë sime, blunë e Klein-it, raftet e librave të Kiefer-it, Njeriun që ecën të Giacometti-t, dhe shkrova poezi për të gjithë. Me pak fjalë, ka kaluar një kohë e gjatë nga atëherë.



Isha 43 vjeç, te Muzeut i Artit Modern të Luizianës, dhe kisha hequr dorë nga këto. Aq shumë saqë, vetëm mendimi për Klein-in, Keifer-in ose Giacometti-n, më bezdiste. Ndoshta Giacometti, veçanërisht. Ai ishte diçka e shkuarnë jetën time të brendshme. Nuk mund të shihja një skulpturë të Giacometti-t pa një ndjesi të çuditshme ankthi, sikur thjesht më duhej të dëgjoja në sfond poezinë e shkëlqyer të poetit norvegjez, Tor Ulven: "Më në fund një njeri shpërfaqet / / si aftësia e gurit për të bërtitur".

Kisha hequr dorë krejtësisht nga të gjithë këto dhe mbi aftësinë e gurit për të bërtitur. Kisha hequr gjithashtu dorë prej të gjitha teksteve të brendshme në universin e Giacometti-t. Kisha hequr dorë prej të gjithë autorëve të cilët qëndronin dhe mërmërisnin me vete në habi; Giacometti … Kisha hequr dorë nga mendimi se nëse koha është e pamëshirshme dhe e pakapërcyeshme, hapësira nuk është, dhe që ky është sekreti pas gjithë skulpturave, pas artit, që mund të marrë formë, që koha mund të ndalet, që hapësira e merr përsipër dhe e bën kohën të prekshme, oooh, sa bukur, sa prekëse. Jo, kisha hequr dorë prej gjithë kësaj, dhe kishte kaluar një kohë jashtëzakonisht e gjatë që nga rinia ime e deri në këtë moment kur po nxitoja përmes korridoreve të Muzeut të Artit Modern të Luizianës duke kërkuar dhomën me aktivitetin letrar.

Por ja çfarë ndodhi më pas: diçka më kapi syri, poshtë në të majtën time. Aty gjendej një skulpturë e vogël brenda diçkaje që ngjasonte me një akuarium, një vitrinë e kapur në mur. Thuajse dëgjova një lloj fishkëllime ndërkohë që u përkula. Busti qëndronte mbi një bazament të vogël që dukej sikur ishte shkëputur nga një bazë më e madhe, dhe njeriu që qëndronte sipër gjithashtu dukej sikur ishte shkëputur, jo gdhendur, sikur dy gishta e kishin gërmuar, kishin gjetur personin që po fshihej aty, ashtu të pambaruar, e nxorën dhe më pas e lëshuan sapo gishtat e shtrënguan mirë skulpturën. Kështu ai kishte dalë deri te brinjët e kraharorit dhe nuk ishte shkëputur vërtet nga materiali. Nuk kishte fytyrë, më shumë një prani që po fshihej, por mund ta dalloje që ishte aty, brenda kokës së vogël prej bronzi.



U përkula poshtë, ndërkohë që dukej sikur ai po ngrihej sipër, dhe siç e mbaj mend: u takuam në një pikë të çuditshme pa formë, mes lart e poshtë. Tani që ndodhesha aty poshtë, zbulova se kishte edhe më shumë krijime miniaturë. Një koke e vockël e një gruaje me flokë të shkurtër. Koka e ngushtë e një burri të moshuar, e rikrijuar në bronz me detaje të bukura, por shumë të imëta. Një burrë i hollë i drejtë si një gozhdë qëndronte mbi një copë druri, veçse nuk ishte gozhdë, por një person. Ishin të gjithë mbi bazamente drejtkëndore, të bëra nga i njëjti material si vetë ata.

Dhe çfarë ndodhi më pas? Epo, kjo: ndjeva një lëmsh në fyt dhe u mbusha me lot. Ose versioni i tabloidit: LOTËT DERDHEN. LOTËT MBLIDHEN PREJ VËSHTRIMIT TË FIGURAVE TË VOGLA QË NGRIHEN NGA I NJËJTI MATERIAL SI VETJA E TYRE, DUKE QËNDRUAR NË NJË VITRINË NË MUR. LOTËT RRJEDHIN NË FESTIVALIN LETRAR. AUTORJA E PREKUR THELLË NGA PAMJA E GJENDJES NJERËZORE! (NJË ANALIZË MË E AFËRT E KËTYRE LOTËVE JO E SHKRUAR ME SHKRONJA TË MËDHA mund të thotë: Ne besojmë se lotët ishin rezultat i A) autorja ndjeu se qenia e saj ishte çuditërisht e gjatë (rreth pesë metra) në krahasim me ato skulptura shumë të vogla (asnjë prej të cilave nuk besojmë ishte më shume se 12 cm) dhe t'i shohësh aty brenda shkakton diçka te perspektiva jote dhe ndoshta edhe te kuptimi i jetës, se ekziston njëfarë thelbi që mund të kapet, në skulpturë, dhe që ky thelb është – epo, çfarë është, kur përballesh me faktin se jeta ekziston? Përulësi, ndoshta? Që përmasa e figurave kërkonte përulësi? Apo mund të ishte që lotët u derdhën sepse B) ajo kuptoi diçka specifike se ç'do të thoshte të ishe njeri aty dhe atëherë në vitin 2018, kur bota dukej se ishte më absurde nga ç'kishte qenë për një kohë të gjatë, kur pikërisht humanitetit i njerëzve ishte zvogëluar e tkurrur dhe barbarizmi i historisë njerëzore kishte dalë nga vendi i tij i fshehur, dhe pamja e një njeriu të vogël që tërhiqet nga një bazament i vogël i kujtojnë asaj se kush jemi ne, se jemi njerëz.

Por a mund të ishin shkaktuar lotët edhe nga C) të kuptuarit, fare i thjeshtë, i asaj çfarë duhet për të portretizuar të njerëzishmen në art, dhe të punosh me një material, t'i japësh formë. Figurat u krijuan nga i njëjti material që ishin vetë. Që themeli ishte kaq i rëndësishëm. Sepse në këtë pikë të historisë, në të njëjtën kohë që barbarizmi njerëzor ishte futur te postet e pushtetit anembanë botës, beteja mes së vërtetës dhe trillimit, asaj çfarë është e vërtetë dhe çfarë është false, po jehonte përmes gazetarisë dhe artit. Dhe në këtë pikë, të paktën në historinë e letërsisë norvegjeze, vala e zgjatur e autofiksionit në letërsi, e cila ndiqej nga një valë e verifikimit të fakteve në fiksion, mund të shkaktonte rraskapitje te disa autorë, sidomos te ata që ndiheshin të mbingarkuar kur shihnin figura të vogla që dilnin nga bazamente të mëdha në një vitrinë në mur te Muzeu i Artit Modern të Luizianës, dhe që qëndronin aty duke menduar se nëse askush nuk do ta krahasonte atë, diskutimi mbi lidhjen mes fiksionit dhe faktit me skulpturat e Giacometti-t, dhe në veçanti, e vogla që dukej sikur ishte shkulur nga bazamenti, mund të thuhej se verifikimi i fakteve do të kërkonte një fytyrë të dallueshme, dhe ne nuk do ta donim atë shtresë materiali që fshihte fytyrën.

Verifikimi i fakteve nuk do ta aprovonte as bazamentin, e figura nuk duhet të ishte duke dalë nga asnjë lloj baze e bërë me të njëjtin material, dhe kjo këtu kishte dy bazamente. Por, kjo ishte e tepërt, sikur figura nuk e bëri të qartë mjaftueshëm: ky portretizim i humanitetit që ke përpara teje është i bërë nga një material artistik, dhe nuk është mish e gjak.

Verifikimi i fakteve nuk e do një shtyllë fiksioni, këtë mendoj unë, mendoi autorja që tashmë ishte gati duke u mbështetur te xhami.

Verifikimi i fakteve kërkon që çdo gjë të jetë e vërtetë. Të jem e sinqertë, autores, e cila, sigurisht, isha unë, i kishte ardhur në majë të hundës i gjithë debati ndërkohë që rrinte aty duke parë figurën e vogël, e lodhur deri në palcë – palcë, duhet ta theksojmë, e cila ishte e përbërë nga gjuha, pjesët e shkrimit, struktura e fjalisë, (mes gjërave të tjera, një fjali e parë shumë e gjatë), skeleti i një strukture eseje gjithëpërfshirëse që lidhi momentin marramendës kur "unë" u përkula për të parë më nga afër skulpturën në miniaturë, me distancën e jetës dhe punës, etj., të Giacometti-t.

Sepse është fantastike, apo jo? Që ishte mesa duket kur Giacometti po punonte mbi skulpturën që quhej "Duart që mbajnë boshllëkun", ndjeu nevojën për të përdorur sërish një model, kështu që u largua nga surrealizmi, sepse a nuk është kjo ajo për të cilën pyesim veten të gjithë, si të punojmë me duart dhe boshllëkun.

M'u kujtua sërish kjo ca kohë më parë kur lexova artikullin mbi imagjinatën të Mary Ruefle: "Është e pamundur për mua të shkruaj për imagjinatën; është sikur t'i kërkosh peshkut të përshkruajë detin". Dhe m'u kujtua kjo sërish kur lexova diçka që kishte thënë Giacometti, e cila ishte cituar në një artikull te The Guardian: "Arti është vetëm një mjet për të parë. Çfarëdo që unë shoh, e gjitha më surprizon dhe më shpëton, e nuk jam fort i sigurt se çfarë shoh". Dhe unë mendova sërish për këtë kur lexova se Giacometti ishte korrigjuar nga vetë babai i tij, piktori, kur do të pikturonte një natyrë të qetë me dardha. Babai i tij i kishte pikturuar frutat e natyrës së qetë në madhësi normale, por kur Alberto, 18 vjeç, filloi të pikturonte, "dardhat ishin të vogla. Fillova përsëri, por çdo herë, ishin po aq të vogla". Dhe sado i acaruar të bëhej babai i tij, dhe t'i kërkonte t'i pikturonte sërish, dhe sado që Alberto përpiqej, dardhat ishin gjithmonë shumë, shumë të vogla. Por asnjë nga këto nuk do të zgjasë gjithsesi. Është e diel sot. Distanca nga kjo pikë, kur ulem këtu për të shkruar, te një kohë kur unë nuk ekzistoj më dhe jam fshirë përgjithmonë, është e pambarimtë. Familja ime është jashtë dhe unë jam ulur në zyrën time duke shkruar, ndërkohë që era tund bredhin dhe thuprat në anën tjetër të rrugës, në ishullin e vogël të natyrës që është lënë këtu në mes të tokës së shtëpisë-tarracë, dhe po kaq shpesh tufa të vogla flokësh bore drejtohen horizontalisht poshtë rrugës, ndërkohë që përpiqem të kujtoj atë moment në Muzeun e Artit Modern të Luizianës, kur po kërkoja diçka tjetër, dhe rrugës zbulova Giacometti-n, sërish.

**Exlibris.al/Përktheu E.H.**
**Burimi LitHub**




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Mes lotësh Messi i thotë lamtumirë Barcelonës

BARCELONË, 8 GUSHT (ER) - Lionel Messi mes lotëve të dielën ka thënë fjalët e para në lamtumirën e tij nga Barcelona pas gati 20 vjetëve. Ylli argjentinas ka filluar me lot konferencën për media në ambientet e stadiumit "Camp Nou". "Barcelona është shtëpia jonë dhe kështu u premtova edhe fëmijëve të mi. Falënderoj të gjithë ata që na ndihmuan. Unë jam rritur me vlerat e kësaj shtëpie, duke e trajtuar veten me përulësi dhe respekt. Kështu veprova me të gjithë në këtë shtëpi dhe shpresoj që kjo të mbetet, përveç gjithçkaje që fitojmë. Do të më pëlqente të thosha lamtumirë në një mënyrë tjetër. Unë kurrë nuk e imagjinoja lamtumirën time, por nuk do ta kisha imagjinuar në atë mënyrë. Do të më pëlqente ta bëja në fushë, të kisha dëgjuar një ovacion të fundit", ka thënë Messi.

Ai shpreson se një ditë do të kthehet sërish për të qenë pjesë e këtij klubi. "Shpresoj se mund të kthehem për të qenë pjesë e këtij klubi në një moment. Shpresoj se mund të kontribuoj diçka në mënyrë që ky të vazhdojë të jetë klubi më i mirë në botë. Jam i sigurt që kam harruar shumë gjëra, por kjo është ajo që mund të them tani, nuk jam në gjendje të mendoj dhe fjalët dalin", ka thënë fituesi i gjashtë topave të Artë.

Ai ka treguar se kishin rënë dakord me presidentin Joan Laporta për ta vazhduar bashkëpunimin, por ndodhi e kundërta. "Realiteti është se kur ndodhen zgjedhjet unë shkova për të ngrënë me presidentin dhe biseduam. Gjatë atij takimi u binda për të vazhduar, pasi edhe ai dëshironte ashtu. Pra, ne ramë dakord dhe nuk kishim asnjë problem. Pastaj ndodhi ajo që ndodhi. Ne tashmë e dinim se çfarë kishim planifikuar të bënim", ka thënë Messi.

Messi gjatë karrierës ka zhvilluar 778 paraqitje me Barcelonën, ka shënuar 672 gola dhe ka dhuruar 305 asiste dhe ka fituar 35 trofe.






## Messi flet për transferimin e mundshëm te PSG-ja

Ylli argjentinas gjatë kësaj konference ka zbuluar edhe të ardhmen e tij, duke deklaruar se PSG-ja është opsioni i tij. Messi ka potencuar se palët janë në bisedime, ndonëse nuk ka asgjë konkrete. "Paris Saint-Germain është një mundësi, po. Për momentin asgjë nuk është konfirmuar. Kam marrë shumë telefonata pas deklaratës së Barcelonës. Ne po flasim për të", ka deklaruar Messi.

# Përfundojnë Lojërat Olimpike 'Tokio 2020'

TOKIO, 8 GUSHT (ER) - Lojërat Olimpike "Tokio 2020" janë shpallur të mbyllura të dielën nga shefi i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach.

Në ceremoninë e mbylljes, ai ka deklaruar se ngjarja sportive 16-ditore i kishte sjellë botës njëfarë shprese gjatë pandemisë së koronavirusit. "Që nga fillimi i pandemisë për herë të parë e gjithë bota u bashkua. Ne epiqendër u kthye sporti. Duke ndarë momente gëzimi dhe frymëzimi, miliarda njerëz në të gjithë globin u bashkuan përmes emocioneve", ka deklaruar Bach, duke thënë se kjo jep shpresë për të ardhmen.





Ai mbylli zyrtarisht Olimpiadën 2020, duke shënuar edhe fundin e udhëtimit olimpik që është vlerësuar si ndër më sfiduesit për shkak të pandemisë së Covid-19. Bach ka falënderuar organizatorët japonezë dhe mijëra vullnetarë që u angazhuan për përgatitjen e tyre.

Garat u zhvilluan në kushte të rrepta të kufizimeve kundër koronavirusit.

Lojërat ishin paraparë të mbaheshin vitin e kaluar, por ato u shtynë për shkak të pandemisë.

Dy xhudistet e Kosovës, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, morën dy medalje të arta në këto lojëra. Kjo ishte hera e dytë që Kosova mori pjesë në Lojërat Olimpike, ku në Rio më 2016 xhudistja Majlinda Kelmendi fitoi medalje të artë në kategorinë e saj.

Të dielën, në ditën e fundit, Shtetet e Bashkuara shënuan fitore në volejboll, çiklizëm në pistë dhe basketboll për femra duke dalë në vendin e parë me 39 medalje ari, vetëm një përpara Kinës.

Medalja e 339 -të dhe e fundit e artë shkoi për ekipin e vaterpolit për meshkuj të Serbisë.

Tridhjetë e tre sporte janë zhvilluar në stadiume kryesisht të zbrazëta dhe sportistët kanë jetuar gjatë këtyre ditëve në kushte të rrepta për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit.

Lojërat Olimpike Verore 2024 do të mbahen në Paris të Francës.

## Drenica paraqet pesë transferimet e verës dhe rinovon kontratat me katër yjet e ekipit

Skenderaj, 8 gusht - Skuadra nga Skenderaj ka vazhduar kontratat me katër futbollistë të rëndësishëm që kishte edicionin e kaluar. Emrat si Shkelzen Lushtaku, Kreshnik Uka, Denisson Silva e Harallamb Qaqi do të vazhdojnë të jenë pjesë e kuqezinjve. Ndërkohë ekipi i drejtuar nga Tahir Lushtaku ka bërë afrimin e pesë futbollistëve cilësorë. Arbios Thaqi rikthehet në klub ashtu si Armend Abazi, derisa kontratë me Drenicën kanë nënshkruar edhe të rinjtë Erjon Morina dhe Erdin Dushi. Përforcimi nga jashtë është ai i Samuel Noye që ka përvojë nga futbolli norvegjez, qipriot dhe portugez.



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

06 JUL 2021

## ДИРЕКЦИЈА ЗА ОБРАЗОВАЊЕ И КУЛТУРУ

На основу чланова 67, 68 и 69 Законом о Јавним службеницима Br.06/L-114, Закона о образовању у општинама РК бр.03 / L-068, Закона о предуниверзитетском образовању РК бр. 04/L -032, као и на основу Административног упутства (МОНТ) бр.05/2021, о нормативу професионалног кадра општег образовања и на основу Административног упутства 07/2017 о регулисању процедура конкурса у јавним сектору општина Грачаница, објављује:

### КОНКУРС

за допуну слободних радних места

**Институција:** Општина Грачаница

**Одељење/Управа:** Одељење за образовање и културу;

**Назив радног места:** Професор уставног права

**Број позиција:** две (2);

**Врста позиције:** Службеник јавних служби;

**Назив надзорног:** Директор дирекције;

**Ниво/Коефицијент:** Коефицијент А-459;

**Радни сати:** 40 сати недељно,;

**Период уговора:** На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад);

**Главни задаци:**

1. Да реализује наставни план и програм за дотично радно место, на основу закона и подзаконским актима које регулишу релевантне области за наведено радно место;
2. Да спроводи радне обавезе обезбеђујући квалитет и професионалне компетенције у наставном процесу;
3. Да припреми редовни годишњи, месечни и дневни план, у складу са потребама за усклађивање наставе, способности и индивидуалних талената сваког ученика;
4. Да има знања о ширем репертоару наставних стилова и да буде у стању да их примењује тако да најбоље одговарају ситуацији у учионици;
5. Да на ефикасан начин искористи ресурсе које има на располагању;
6. Да планира, руководи и надгледа наставу и понашање сваког ученика;
7. Да спроводи нове методологије наставе и процене у складу са упутствима;
8. Да створи радну атмосферу и дисциплину, без коришћења метода кажњавања или различите облике понижавања ученика;
9. Да редовно контролише и води евиденцију о успеху и индивидуалном напретку сваког ученика као и да буде у стању да исправно извештава родитеље или старатеље детета о постигнутом напретку ученика, према потреби;
10. Да код ученика пробуди радозналост за учењем да их подстиче да уче на независтан начин;
11. Да се побрине за одрживи професионални развој према предвиђеном плану и да се стара за реализацију планирања;
12. Да буде у континуираној координацији са породицом свог ученика развијајући индивидуалне састанке са родитељима / старатељима деце;
13. Да помогне колегама на подизању квалитета рада;
14. Да надгледа и упути студенте који учествују у наставном процесу;
15. Да учествује у организационом раду школе;
16. Да активно учествује у припремању програма и догађаја у школи;
17. Да активно учествује у ван-наставном организовању са ученицима и да са одговорношћу обавља екскурзије са ученицима унутар или ван земље;
18. Да покаже поштовање, колегијалност и не-дискриминационо понашање према сарадницима са којима ради;
19. Да поштује директан ауторитет службеника, и да обавља обавезе које му могу одредити. Радни задаци треба да буду у складу са важећим законодавством.
20. Да не захтева или прихвати упутства у вези са обављањем обавеза о раду од стране ниједног другог органа осим ООО-а или лица која су одређена са њене стране;
21. Да не користи позицију посла за приватне интересе у корист неке треће стране, укључујући породицу, друштво или друштвени круг;
22. Да обавља максималну дискрецију у вези са свим питањима о раду, укључујући чување информација ( уколико нису јавне) , које се повезују са процесима рада и њених створених односа, не објављујући ове информације ниједном физичком или правном лицу, осим када су сличне информације предвиђене у оквиру обавеза према овом уговору или овлашћењу од стране службеника који извештава;
23. Да одржи час разредног и дневног дежурства;
24. Запослени је у обавези да поштује кодекс облачења и понашања, који је одређен интерном уредбом школе и другим законским и подзаконским актима;

**Услови и квалификације:**

-Завршен правни факултет (мастер 300 ECTS),
-Четворогодишњи систем,
- Bacelor – (четворогодишњи 240 ECTS)

**Потребна документа:**

- Формулар за пријаву;
- Факултетска диплома - (оверена копија);
-Лична карта (копија)
-Доказ о радном искуству (уколико поседује)
-Добро познавање рада на рачунару

**Конкурс (рок аплицирања) је отворен 15 дана од 09.08.2021- 23.08.2021. године**

Формулари за пријаву се могу преузети и поднети сваког радног дана у писарници општине Грачаници у периоду од 08:00 до 16:00 часова.

На разговор ће бити позвани само кандидати који испуњавају критеријуме и уђу у ужи избор.

Пријаве мушкараца и жена из свих заједница су добродошле.

Пријаве предате након истека рока неће бити прихваћене, а неисправне пријаве ће бити одбијене.

Директор

Бранкица Нићић

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P " Hysni Zajmi" Gjakovë

▶ Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ "DEPO STEEL" Sh.p.k. me adresë në Bresje -4, Fushë Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: NUI 810545171.

▶ Fjolla Duraku nga gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi".

▶ Qëndrim Grezda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi"

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

06 JUL 2021

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

**DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË**

Në bazë të neneve 67, 68 dhe 69 të Ligjit për zyrtarët publikë nr.06/L-114, Ligjit për arsimin në komunat e RK-së nr.03/L-068, Ligjit për arsimin parauniversitar në RK-në nr.04/L-032, si dhe në bazë të Udhëzimit administrativ (MASHT) nr.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm dhe të Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Graçanicës shpall këtë:

**KONKURS**

për plotësimin e vendeve të lira të punës

**Institucioni:** Komuna e Graçanicës

**Drejtoria/Administrata:** Drejtoria për Arsim dhe Kulturë

**Titulli i vendit të punës:** Profesor i së drejtës kushtetuese

**Numri i pozitave:** Dy (2)

**Lloji i pozitës:** Zyrtar i shërbimit publik

**Emri i mbikëqyrësit:** Drejtor i Drejtorisë

**Niveli/Koeficienti:** Koeficienti A-459

**Numri i orëve të punës:** 40 orë në javë

**Periudha e kontratës:** Për një periudhë të pacaktuar kohore (me punë provuese të konfirmuar më parë)

**Detyrat kryesore:**

1. Ta zbatojë plan programin mësimor dhe programin për vendin e punës në fjalë, në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e punës në fjalë;
2. T'i zbatojë detyrimet e punës duke siguruar cilësi dhe kompetenca profesionale në procesin mësimor;
3. Ta përgatisë planin e rregullt vjetor, mujor dhe ditor, në përputhje me nevojat për harmonizimin e mësimdhënies, aftësive dhe talenteve individuale të secilit nxënës;
4. Të ketë njohuri për një repertor më të gjerë të stileve të mësimdhënies dhe të jetë në gjendje t'i zbatojë ato për t'iu përshtatur më mirë situatës në klasë;
5. T'i përdorë në mënyrë efikase burimet që i ka në dispozicion;
6. Të planifikojë, menaxhojë dhe mbikëqyrë mësimdhënien dhe sjelljen e secilit nxënës;
7. T'i zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me udhëzimet;
8. Të krijojë një atmosferë punuese dhe disiplinë pune pa përdorimin e metodave të ndëshkimit ose formave të ndryshme të poshtërimit të nxënësve;
9. Të monitorojë dhe mbajë rregullisht evidencë për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënës, si dhe të jetë në gjendje t'u raportojë siç duhet prindërve ose kujdestarëve të fëmijës për progresin e bërë nga nxënësi, sipas nevojës;
10. Të zgjojë kureshtjen tek nxënësit për të mësuar dhe t'i inkurajojë ata të mësojnë në një mënyrë të pavarur;
11. Të kujdeset për zhvillimin e qëndrueshëm profesional sipas planit të planifikuar dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit;
12. Të jetë në koordinim të vazhdueshëm me familjen e nxënësit të tij/saj duke zhvilluar takime individuale me prindërit/kujdestarët e fëmijëve;
13. T'i ndihmojë kolegët në rritjet e cilësisë së punës;
14. T'i mbikëqyrë dhe udhëzojë nxënësit që të marrin pjesë në procesin mësimor;
15. Të marrë pjesë në punën organizative të shkollës;
16. Të marrë pjesë në mënyrë aktive në përgatitjen e programeve dhe ngjarjeve në shkollë;
17. Të marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitete jashtëshkollore me nxënës dhe t'i kryejnë ekskursione me përgjegjësi me nxënës brenda ose jashtë vendit;
18. Të tregojë respekt, kolegjialitet dhe sjellje jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon;
19. Ta respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit dhe t'i kryejë detyrat që mund t'i ngarkohen nga ai/ajo. Detyrat e tij të punës duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
20. Të mos kërkojë ose pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrimeve të punës nga ndonjë organ tjetër përveç DAK-së ose personave të caktuar nga ajo;
21. Të mos përdorë pozitën e punës për interesa private në interes të një pale të tretë, duke përfshirë familjen, shoqërinë ose rrethin shoqëror;
22. Të ushtrojë diskrecion maksimal lidhur me të gjitha çështjet e punës, duke përfshirë ruajtjen e informacionit (nëse nuk është publik), që është i ndërlidhur me proceset e punës dhe marrëdhëniet e tij të vendosura, pa zbuluar këtë informacion për ndonjë person fizik ose juridik, përveç kur informacionet e ngjashme janë të parapara në kuadër të detyrimeve sipas kësaj kontrate ose autorizimit nga zyrtari raportues;
23. Ta mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore;
24. I punësuari është i detyruar që ta respektojë kodin e veshjes dhe sjelljes, i cili është i përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.

**Kushtet e kualifikimit:**
- Fakulteti i kryer juridik (master 300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS)

**Dokumentet e nevojshme:**
- Formulari për aplikim
- Diploma e fakultetit (kopja e verifikuar)
- Letërnjoftimi (kopja)
- Dëshmia për përvojën e punës (nëse e posedon)
- Aftësi të mira për punë në kompjuter

**Konkursi (afati për aplikim) është i hapur për 15 ditë dhe atë nga 09.08.2021 deri më 23.08.2021.**

Formularët për aplikim mund të shkarkohen dhe dorëzohen çdo ditë pune në Shkrimoren e Komunës së Graçanicës dhe atë prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

Vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret dhe që kanë hyrë në listen e ngushtë për t'u zgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikimet nga burra dhe gra nga të gjitha komunitetet janë të mirëseardhura.

Aplikimet e paraqitura pas skadimit të afatit nuk do të pranohen, ndërsa aplikacionet e pavlefshme do të refuzohen.

Drejtoresha
Brankica Nićić

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi
Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook
www.facebook.com/gjejpuneshpejte

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACINIT*
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
*AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE*
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 914/1
Dt: 06.08.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

# Ri-SHAPLLJE KONKURSI

**Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Malishevë për vitin shkollor 2021/2022**

| Niveli | Institucioni/Shkolla | Vendi | Pozita/Vend i ilirë | Vendi lirë/ Zëvendësim |
|---|---|---|---|---|
| SHML | Qendra e Kompetencës | Malishevë | Një (1) mësimdhënës/e për profilin Dizajn i tekstilit dhe veshjeve (20 orë mësimore); | Vend i lirë |
| | | | Një (1) mësimdhënës /e për profilin Instalues i ujësjellësi e kanalizim dhe ngrohje e klimatizim, (15 orë mësimore); | Vend i lirë |

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;**

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre,duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:**

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

**Procedurat e konkurrimit:**

Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Malishevë.
Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen.
Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P " Hysni Zajmi" Gjakovë

▶ Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ "DEPO STEEL" Sh.p.k. me adresë në Bresje -4, Fushë Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: NUI 810545171.

▶ Fjolla Duraku nga gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi".

▶ Qëndrim Grezda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi"

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT*
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
*AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE*
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 915/1
Dt. 09.08.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr.04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ (MPMS) 07/2017, Udhëzimit Administrativ (MAShT) 07/2017, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur si dhe në bazë të kërkesës se shkollës shpall:

## KONKURS

**Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj – paralelet e ndara në Prishtinë**

Në kontekstin e reformave të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI) ka zhvilluar nivelin e 5 (pestë) të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".
Qendrën e Kompetencës (QeK) në Ferizaj është e akredituar nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON për të ofruar kualifikimin "***Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".***
Për këtë gjeneratë kualifikim "***Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"*** do të ofrohet në paralelet e ndara në Qendrën e Kompetencës (QeK) "Shjefën Gjeçovi" " – Prishtinë dhe Qendrën Burimore "Përparimi" – Prishtinë.
Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj menaxhohet nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur.

| Niveli | Institucioni/Shkolla | Vendi | Pozita | Vend i lirë |
|---|---|---|---|---|
| **SHML** | **Qendra e Kompetencës Ferizaj** | **Prishtinë** | 4 (katër) Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "***Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"*** | Vend i lirë për një (1) vit shkollor) |

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënësit e nivelit të V-të arsimit**

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës;
- Implementon programin e këtij kualifikimi duke respektuar plotësisht standardet BTEC;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me stanadardin e profesionit dhe programin mësimor;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi;
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe AAAPARr-së;
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve;
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të kandidatëve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Merr pjesë në trajnime shtesë të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAAPARr, përfshirë projektet e financuara nga donatorët;
- Ta përditësojë dhe ta përmirësojë në vazhdimësi pakon e materialeve ekzistuese mësimore, dhe të zhvillojë materiale të reja sipas nevojës;
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale, monitoron dhe mbikëqyrë realizimin e praktikës profesionale;
- Kontribuon në aktivitetet e përgjithshme të monitorimit dhe vlerësimit në Qendrën e Kompetencës;
- Bënë hulumtime specifike për fushën/kualifikimin më qëllim të ngritjes se cilësisë dhe transferimin e njohurive dhe shkathtësive adekuate te kandidatët;
- Kontribuon në zhvillimin e praktikës profesionale duke kontaktuar organizata që mund të konsiderohen si partner potencial, në të cilat mund të organizohet praktika profesionale për kandidatët, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e stafit drejtues të Qendrës së Kompetencës;
- Të bashkëpunojë rregullisht me organin drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe akterët përkatës, në mënyrë që t'i realizojë marrëveshjet formale të bashkëpunimit me partnerët e organizatës duke përdorur veglat adekuate juridike për t'i arritur qëllimet e synuara;
- Të përcjellë në vazhdimësi zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të parapara që duhet të fitohen nga kandidatët gjatë praktikës profesionale. Duke pasur parasysh këtë, duhet të krijohet një raport individual për secilin kandidat ku arsyetohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë praktikës profesionale, si dhe ndërlidhjen e tyre me materialet mësimore.

**Kualifikimi, shkathtësitë dhe dokumentacioni i kërkuara:**

- Diploma e nivelit të 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet: Master për Arsim gjithëpërfshirës, Master për Edukim të fëmijeve me nevoja të vecanta ose kualifikim i përafërt;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Të ketë shkathtësi teorike dhe praktike për profesionin e caktuar;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë certifikuar nga PEARSON ose kandidatët e diplomuar në këtë kualifikim**;**
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt.

**Aftësitë shtesë**

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen;
- Shkathtësi themelore kompjuterike dhe kapacitete për t'ia përshtatur në mënyrë sa më të lehtë përdorimin e veglave të TI dhe sistemet e informimit.

**Procedurat e konkurrimit**

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacioni dhe dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen (në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndërtesa MAShTI-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p.n, Prishtinë. Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, CV-ja, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

---

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

## Njoftim për tatimpagues

## ATK publikon veglën "Verifikimi për subvencionim nga Pako e Ringjalljes Ekonomike''

Administrata Tatimore e Kosovës, vazhdimisht është në përpjekje që të ofroj lehtësira më të mëdha për tatimpagues. Nga data 08 Korrik 2021 ofron edhe një shërbim të ri elektronik për tatimpagues, për të cilët ka publikuar veglën "Verifikimi për subvencionim nga Pako e Ringjalljes Ekonomike".

Kjo vegël shërben për të verifikuar personat që kualifikohen apo jo për subvencionim nga Masa 1.1 e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, gjegjësisht Rikthimin në punë të personave që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë "Covid 19".

Çdo punëdhënës, para se të aplikoj për subvencionim nga Masa 1.1 e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, si dhe çdo person tjetër mund të bëjë verifikimin e personit se a mund të përfitoj apo jo nga kjo masë. Kontrollin mund ta bëjë përmes numrit personal të të punësuarit.

Në rastet kur personi plotëson kriteret për subvencionim, gjegjësisht kur personi ishte i punësuar dhe ishte i deklaruar për qëllime tatimore në Administratë Tatimore të Kosovë në periudhën dhjetor/2019 - shkurt/2020 (pa ndërprerje), dhe i njëjti nuk është i punësuar dhe i deklaruar për periudhën prill/2021 - qershor/2021 (pa ndërprerje), sistemi gjeneron Emrin dhe Mbiemrin e personit, që nënkuptohet se ky person kualifikohet për subvencionim nga Masa 1.1 e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Në rastet kur personi nuk plotëson kriteret për subvencionim, sistemi njofton tatimpaguesin se "Ky person nuk kualifikohet për subvencionim nga Masa 1.1 e Pakos së Ringjalljes Ekonomike"

Vegla "Verifikimi për subvencionim nga Pako e Ringjalljes Ekonomike" është në dispozicion të tatimpaguesve në ueb-faqen e ATK-së www.atk-ks.org - tek linku Shërbimet elektronike.

*ATK mban premtimin për kujdesin e vazhdueshëm ndaj tatimpaguesve!*
Administrata Tatimore e Kosovës


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues